

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRI

Adresa: Blv. Bajram Curri", Tirane, Albania, Tel / Fax: +355 4 362397 www.moh.gov.al

Nr. 3580 Prot.

Tiranë më 11/10 2011

URDHËR

Nr. 415, datë 11.10.2011

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr.8025 date 9/11/1995 i ndryshuar "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese" në kuader të forcimit të masave për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jonizuese;

URDHËROJ:

- 1- Ndalohet ndertimi i kabineteve të radiologjisë (Grafii, Skopi, Ct Skaner, Mamografi, Grafi dentare panorameks si dhe pajisje me rreze x) në ambiente me destinacion banimi në godina publike banimi.
- 2- Ndalohet ndërtimi i kabineteve për ushtrim aktiviteti me burime radioaktive të hapura dhe të mbyllura në ambiente me destinacion banimi në godina publike banimi.
- 3- Ndertimi i kabineteve për veprimtari me burime të rrezatimit jonizues (gjeneratore me rreze x) bëhet në godinat e dedikuara për ushtrim aktiviteti me destinacion të ndryshëm nga banim duke marrë miratimin e fqinjëve të parë në kufi me ambjentin.
- 4- Urdhëri Nr.547, datë 14.10.2008, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëhere.

MINISTRI

Petrit VASILI